

Terms of Reference

MONITORIMI I KUVENDEVE KOMUNALE MBI PREMTIMET PËR RINI

[Projekti mbështetet nga Ambasada e Kanadës (CFLI), i implementuar nga KYC]

Fjalët Kyçe: Rini, Monitorim, Zgjedhjet, Premtimet, Kuvendet Komunale.

1. PROJEKTI

Projekti është hartuar në kuadër të programeve strategjike të KYC-it për Zhvillimin dhe Aktivizmin Rinor që synon mbështetjen e zhvillimit të të rinjve për të arritur potencialin e tyre të plotë dhe rritjen e kapaciteteve rinore për pjesëmarrje dhe vendimmarrje. Vetë projekti synon të përmirësojë pozicionin e të rinjve të të gjitha gjinive dhe grupeve të marginalizuara në shoqëri duke marrë përgjegjësi politike në çdo nivel dhe të rrisë pjesëmarrjen e tyre demokratike politike dhe vendimmarrëse përmes zhvillimit të aftësive të tyre monitoruese.

2. QËLLIMI

KYC me qëllim të gjithëpërfshirjes u ka ofruar të rinjve trajnime dhe punëtori për monitorimin, raportim dhe avokim. Këto trajnime janë mbajtur me idenë e monitorimit e zgjedhjeve dhe seancave të Kuvendeve Komunale nga këta pjesëmarrës me qëllim të komunikimit të rekomandimeve për përmirësim njëashtu duke i bërë qeveritë e reja komunale më të përgjegjshme.

3. OBJEKTIVAT

Për të promovuar nevojën për gjithëpërfshirjen politike të rinisë në Kosovë, të rinjtë kanë mbuluar të gjitha 7 regjionet si Prishtinën, Gjakovën, Ferizajn, Gjilanin, Pejën, Prizrenin dhe Mitrovicën si dhe për të siguruar përfshirjen nga të gjitha komunitetet, KYC ka përfshirë edhe komunën e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Lipjanit. Në bazë të të dalurave të raporteve do të implementohen iniciativa në nivel komunal me qëllim të adresimit të nevojave të të rinjëve.

4. RAPORTET E MONITORIMIT

Të gjithë monitoruesit pas monitorimit të seancave kanë pasur detyrë të dërgojnë raportin për mbarëvajtjen e seancës, çështjeve të diskutuara (me theks për të rinjtë), kuorumi, parregullësi etj. Pyetjet të cilat ata janë dashur ti adresojnë në raport kanë qenë:

| | |
|---|------------------------------------------------------------|
| 1 | Temat e diskutuara |
| 2 | A ka pasur parregullësi përgjatë takimit? Nëse po, çfarë? |
| 3 | A janë marrë vendime në këtë takim? Nëse po çfarë vendime? |

| | |
|---|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4 | A ka pasur kuorum në takim? |
| 5 | A janë diskutuar tema në lidhje me të rinjtë? Nëse po, çka më saktësisht? |
| 6 | A është diskutuar apo punuar mbi premtimet publike që janë dhënë nga partitë fituese në fushatat zgjedhore? |
| 7 | A ka pasur pika të reja të propozuara në krahasim me premtimet e dhëna? |
| 8 | Komente |

5. ANGAZHIMI

Vendosja në perspektivë dhe krahasimi i punës së premtuar dhe asaj të bërë nga udhëheqësia aktuale në nivel komunal në periudhën zgjedhore dhe asaj pas, duke u bazuar në raportet e Grupit të Monitoruesve të Rinjë. Sa është e vendosur rinia në fokus kur kemi të bëjmë me mbledhje të këtij karakteri, sa adresohen nevojat e kësaj demografie dhe sa është përfshirja e tyre direkte në vendim-marrje?

6. KRITERET PËR APLIKIM

- Të paktën diplomë Bachelor në shkencë sociale.
- Të paktën (1) një vit eksperiencë me shkrime akademike.
- Të paktën (1) një vit eksperiencë pune në fusha relevante.
- Të paktën (1) një vit eksperiencë me mbledhjen dhe organizimin e të dhënave.
- Person me motiv dhe interes në këtë fushë.

7. DETYRAT E PËRPILUESIT/ES TË RAPORTIT

- Vendosja e të dhënave nga raportet në sistem;
- Shkrimi i raportit;
- Lektorimi;
- Bashkëpunimi me staf rreth shkrimit të raportit;
- Takime të rregullta javore me stafin e KYC.

8. APLIKIMI

Të gjithë të interesuarit të aplikojnë në këtë email: kyckosova@gmail.com ; Me subject: 'KYC: Aplikimi për shkrim të "Raporti mbi monitorimin e Kuvendeve Komunale", duke dërguar CV-në, një ofertë buxhetore për punën dhe një letër motivuese deri më 21 Korrik 2022.

VETËM APLIKANTËT E PËRZGJEDHUR THIRREN NË INTERVISTA!